



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/O3-21 Prot.

Tiranë 24/12/2024

Nr. Dok. 202200926/21

Lënda: Rekomandim për përfundimin e procedurës administrative bazuar në kërkesën e shtetasit O.M, për pajisjen me kontratë furnizimi me ujë.

Drejtuar: Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë, sh.a
Z. Drejtor

Tiranë

Për dijeni: Bashkisë Tiranë
Z. Kryetar

Tiranë.

Entit Rregullator të Ujit
Z. Kryetar

Tiranë

Z. O. M

Tiranë

Të nderuar,

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, sikurse jeni në dijeni ka depozituar një ankesë ndaj Ujësjetllës-Kanalizime sh.a, Tiranë, (UKT), shtetasi O.M, i cili ankohet për ndërprerjen e lidhjes së ujit të pijshëm.

Rrethanat e rastit

Ankuesi shpjegon se në vitin 1990 është larguar së bashku me familjen jashtë shtetit, në emigracion. Në banesën e tij të ndodhur në rrugën “Kongresi i Manastirit” nr. 63/1, Tiranë, ka jetuar familja e vëllait të bashkëshortes së tij, B. H. Kur është kthyer në vitin 2021 në Shqipëri, ankuesi është paraqitur pranë UKT-së dhe ka bërë një kërkesë për rilidhjen e ujit. Aty është vënë në dijeni të faktit se kontrata e furnizimit me ujë ishte në emrin e kunatit të tij B. H dhe se për të mundësuar riaktivizimin e kontratës dhe ndryshimin e emrit në të duhet të paguajë një detyrim të pashlyer, në vlerën 116.950.40 lekë, detyrim i cili nuk është në emrin e tij, por të të ndjerit kunatit të tij B.H, i cili ka ndërruar jetë në vitin 2003. Më tej ankuesi shpjegon se ai ka banuar në këtë banesë që nga viti 1955 dhe nuk e kupton se si është bërë ndryshimi i emrit në kontratën e furnizimit me ujë ndërkohë që ndjeri B.H nuk ka patur asnjë të drejtë mbi pronën për të cilën i është lidhur kontrata e furnizimit me ujë. Lidhur me këtë çështje ai ka paraqitur ankesë pranë UKT-së, në të cilën ka kërkuar rilidhjen e ujit dhe ka sqaruar se ky detyrim i pashlyer nuk i takon atij për ta shlyer. Por gjithashtu ai sqaron se është edhe në pamundësi ekonomike, sepse së bashku me bashkëshorten e tij janë një çift i moshuar dhe kanë të ardhura të pakta për shkak se marrin pensione të ulta. Por deri më sot nuk ka gjetur ende zgjidhje.

Gjendur para kësaj situate ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje dhe zgjidhjen e këtij problemi, me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të tij të ligjshme.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore të formës dhe të përmbajtjes për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, respektivisht nenet 13, 17, shkronja “a”, dhe 18, shkronja “b”, ka vendosur të pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

Qëndrimi i Ujësjetës-Kanalime Tiranë sh.a, lidhur me rastin.

Për shqyrtimin me objektivitet të kësaj çështje dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, në vështrim të nenit 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij, si dhe në nenin 19, shkronja “b”, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”, me shkresën nr. K3/O3-2 prot., datë 18.07.2022, kemi kërkuar nga UKT-ja, dhënien e shpjegimeve dhe të informacionit nëse qëndrojnë pretendimet e ankuesit si dhe mundësinë e zgjidhjes së problematikave të tij.*

Me shkresën nr. K-2029/1 prot., datë 04.08.2022, UKT-ja, na ka kthyer përgjigjen se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe kontrollit në (SMI) Sistemi i Menaxhimit të Informacionit, për shtetasin e përmendur në shkresë z. O.M nuk rezulton asnjë kontratë e rregjistruar në sistem në emër të tij për kontrata për shërbime me UKT-në. Në vijim, keni kërkuar që t’u vihet në dispozicion numri i kontratës ose një faturë tatimore ku pasqyrohet emër/mbiemër i abonentit dhe pagesat e kryera për kontratën e lidhur me objektin e shtetasit O.M.

Në këto kushte, me shkresën nr. K4/04-5 prot., datë 19.10.2022 “kërkesë për informacion dhe dokumentacion shtesë”, i jemi drejtuar ankuesit O.M, i cili me shkresën nr. K4/04- 6 prot., datë 15.11.2022, ka paraqitur dokumentacionin plotësues përkatës, të cilin ua kemi përcjellë juve.

Meqenëse nuk ka patur reagim nga ana juaj, për nevoja të shqyrtimit të kësaj çështje nga ana e institucionit tonë, ju jemi ridrejtuar me shkresat nr. K3/O4-7 prot., datë 30.11.2022, nr. K3/O4-8 prot., datë 27.01.2023 dhe nr. K3/O4-9 prot., datë 07.04.2023, në të cilat kemi kërkuar të na dërgoni një informacion sa më konkret dhe gjithëpërfshirës, si dhe dokumentacionin përkatës ligjor që ka të bëjë me çështjen.

Me shkresën nr. K-966/1 prot., datë 24.04.2023, “kthim përgjigje”, na keni informuar, ndër të tjera se, për shtetasin O.M nuk rezulton asnjë kontratë e rregjistruar në SMI. Në vijim bëni me dije se ky shtetas ka kërkuar që të bëhet ndryshimi i emrit dhe riaktivizimi i kontratës me nr. 018389-1, e cila në SMI rezulton në emër të z. B.H. Ankuesi O.M ka dorëzuar pranë

zyrave të UKT-së, dokumentacionin përkatës për riaktivizimin e kontratës nr. 018389-1 dhe ndryshimin e emrit dhe është njoftuar verbalisht që duhet të dorëzojë kopje të dokumentit të identifikimit për të, si dhe jeni shprehur se ankuesi duhet të marrë përsipër edhe likuidimin e detyrimeve me vlerë 104,031,80 lekë (deri më datë 14.04.2023).

Lidhur me sa sipër kemi vënë në dijeni ankuesin nëpërmjet shkresës nr. K3-O4-11 prot., datë 29.05.2023, i cili më datë 17.07.2023, është paraqitur pranë institucionit tonë dhe ka deklaruar se e ka dorëzuar pranë jush **dokumentin e identifikimit, por nga ana tjetër ai është shprehur se nuk është dakord për shlyerjen e detyrimeve, pasi ato nuk i përkasin atij, por janë detyrime që i përkasin shtetasit B.H, në emër të të cilit ka qenë edhe kontrata e furnizimit me ujë me UKT-në.**

Në vijim të kësaj korrespondence, për të qartësuar dhe për të hedhur dritë bazuar në dokumentacionin referues përkatës të rastit, duke patur në konsideratë faktin se detyrimet lindin nga kontrata ose nga ligji, iu jemi drejtuar në mënyrë të përsëritur me shkresat nr. K3/O4-13 prot., datë 21.07.2023 dhe nr. K3/O4-15 prot., datë 19.10.2023, ku ju kemi kërkuar të na dërgoni një informacion shtesë si dhe dokumentacionin përkatës duke i dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme të cilat i kemi konsideruar të rëndësishme në kuadër të planit të hetimit të rastit. Konkretisht:

- Në kushtet kur ankuesi O.M ka dorëzuar kartën e identitetit pranë jush a i është bërë lidhja e ujit të pijshëm si dhe e kontratës përkatëse?
- Nëse jo na sqaroni arsyet ligjore që përligjin këtë situatë?
- A është lëshuar urdhër ekzekutimi në gjykatë për detyrimet e faturave të papaguara të shtetasit **B.H**?
- Çfarë veprimesh janë ndërmarrë nga ana juaj përgjatë kësaj kohe për vjeljen e këtij detyrimi të pashlyer ?
- Cila është bazueshmëria ligjore që këtë detyrim ia kërkon ta shlyejë ankuesi O.M dhe jo trashëgimtarët e të ndjerit **B.H**, aq më tepër ndodhur në kushtet kur ashtu sikurse edhe ju shpjegoni për z. O.M nuk rezulton asnjë kontratë e rregjistruar në sistem në emër të tij për kontrata për shërbime Ujësjellës-Kanalizime Tiranë, sh.a”?
- Në kushtet kur detyrimi i rrjedhur nga faturat e papaguara të ujit nuk ishte shlyer nga i ndjeri B.H brenda afatit 30 ditor të përcaktuar sipas nenit 10 pika 1 (të kontratës), përse nga ana juaj nuk është ndërprerë furnizimi i tij me ujë ?

Me shkresën nr. K-1971/1 prot., datë 16.11.2023, lidhur me sa sipër, na keni kthyer përgjigjen se: “Duhet të merren masa për shlyerjen e detyrimeve të kontratës nr. 018389-1, për të cilën z. O.M ka kërkuar të bëhet riaktivizim dhe ndryshimi i emrit pasi kjo kontratë rezulton në emër të B.H në SMI. Për shtetasin O.M nuk rezulton asnjë kontratë e regjistruar në SMI. Referuar akt verifikimit të datës 16.10.2023, të mbajtur nga grupi i punës së Njesisë Zonale 1, rezulton se: “Objekti që i përket kontratës, me nr. 018389, shtëpi private një katëshe me adresë në rrugën : Kongresi i Manastirit” ka të instaluar ujëmatësin me të dhëna të tipit: NWM, dimensionin $\frac{3}{4}$, shasia 19033871, vula 012018603, leximi: 7 m3. Z. O.M, **ka dorëzuar pranë zyrave të UKT-së, dokumentacionin përkatës për riaktivizimin e kontratës dhe ndryshimin e emrit dhe është njoftuar verbalisht për dorëzimin e dokumentit të identifikimit për të bërë të mundur riaktivizimin e kontratës dhe ndryshimin e emrit, por nga ana e tij ky dokumentacion nuk iu është vënë ende në dispozicion. Z. O.M duhet të paraqitet pranë zyrave të UKT-së, për të dorëzuar dokumentin e identifikimit (ID) dhe pasi të marrë përsipër likuidimin e detyrimeve me vlerë 110,252.40 lekë (deri më datë 26.10.2023), e më pas do të vijohet me procedurën për riaktivizimin dhe ndryshimin e emrit për kontratën nr. 018389-1”.**

Në analizë të shkresës së mësipërme kemi konstatuar se përgjigja e dhënë është identike me pararendësen tuaj, por ndërkohë ju kemi bërë me dije se edhe pse është kthyer përgjigje në aspektin formal, në vlerësimin e Avokatit të Popullit përgjigjet tuaja nuk mund të konsiderohen të tilla në aspektin substancial, pasi shpjegimet e dhëna nuk kanë qenë ezauruese, sepse nuk i kanë dhënë përgjigje në mënyrë eksplicite asnjërës prej pyetjeve të parashtruara nga ana jonë në lidhje me problematikën e rastit sa sipër, si dhe të pasqyruara në shkresat tona. Gjithashtu, nga përmbajtja e kësaj shkrese rezulton se është thjesht një përsëritje e informacionit të dhënë nga ana juaj në shkresën tuaj të mëparshme nr. K- 2029/1 prot., datë 04.08.2022. (pa u marrë **në konsideratë nga ana juaj edhe fakti që gjatë kësaj kohe nga ana e ankuesit është dorëzuar pranë jush dokumenti i tij i identifikimit ashtu sikurse ju ia kishit kërkuar).**

Po ashtu jemi shprehur se ky qëndrim për pasojë nuk ndihmon në sqarimin më tej të situatës dhe ka penguar në vijimin e hetimit administrativ nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit. Në këto kushte, iu jemi ridrejtuar në mënyrë të përsëritur me shkresat nr. K3/04-17 prot., datë 26.02.2024 dhe nr. K3/04-18 prot., datë 27.03.2024, që të na dërgoni një

informacion sa më konkret, si dhe dokumentacionin përkatës për dhënien e përgjigjeve të pyetjeve të specifikuara nga ana jonë.

Në përgjigje të shkresave sa sipër, me Tuajën nr. K1971/1 prot., datë 09.04.2024, na keni kthyer sërish përgjigjen sa më poshtë vijon:

“Institucionit Tuaj dhe z. O.M i është kthyer përgjigje nëpërmjet shkresave... duke ju vënë në dijeni se duhet të merrni masa për shlyerjen e detyrimeve për kontratën nr.0188389-1, për të cilën z. Osman Mersinaj ka kërkuar të bëhet riaktivizim dhe ndryshimi i emrit, pasi kjo kontratë rezulton në emër të B.H në SMI. Për shtetasin O.M nuk rezulton asnjë kontratë e regjistruar në SMI. Z. O.M ka kërkuar rilidhjen e ujit duke pretenduar që ai ka banuar në këtë objekt që nga viti 1955. Për të vazhduar me procedurat për riaktivizimin e kontratës me nr.018389-1 dhe ndryshimin e emrit duhet të na vihet në dispozicion dokumentacioni përkatës (dokument identifikimi ID), si dhe të shlyhen detyrimet në total në vlerën 116,936.00 lekë deri më datë 07.03.2024, për kontratën me nr. 018389-1”.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit, konkluzione dhe rekomandime

Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë përfaqëson institucionin funksional, i cili ka detyrimet dhe përgjegjësitë publike për shërbimet e furnizimit me ujë, si dhe të kanalizimeve të ndotura në zonën e qytetit të Tiranës.

Vlerësojmë se lidhur me rastin në fjalë, veprimtaria administrative e kryer prej **UKT-së** nuk ka qenë efikase dhe nuk i është përgjigjur situatës faktike të rastit si pasojë e së cilës ka rezultuar se deri më sot akoma nuk është zgjidhur problematika e ankuesit O.M, për lidhjen e kontratës së ujit me të, pasi ju e konsideroni atë si vazhdim të procedurës për riaktivizimin e kontratës me nr.018389-1, si dhe për ndryshim të emrit të kontratës, me pretendimin e ekzistencës së detyrimeve të prapambetura ende të pashlyera që rrjedhin nga kjo kontratë.

-I-

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se midis shtetasit O.M dhe **UKT-së** nuk është lidhur asnjë kontratë e furnizimit me ujë, fakt ky që rezulton edhe nga SMI, ku nuk rezulton e regjistruar asnjë kontratë në emër të ankuesit O.M. Detyrimet e prapambetura që ju kërkoni

të shlyhen nga shtetasi O.M, i përkasin detyrimeve që rrjedhin nga kontrata me nr.018389-1, e lidhur midis **UKT-së**, dhe të ndjerit B.H.

Kuptimi i detyrimit është sanksionuar në nenin 419 të Kodit Civil. Në këtë dispozitë është parashikuar se: *“Detyrimi është një marrëdhënie juridike me anën e së cilës një person (debitori) detyrohet të japë diçka ose të kryejë apo të mos kryejë një veprim të caktuar në dobi të një personi tjetër (kreditore), i cili ka gjithashtu, të drejtë të kërkojë t’i jepet diçka, ose të kryhet apo të mos kryhet veprimi”*.

Në nenin 420 të Kodit Civil është parashikuar se: *“ Detyrimet lindin nga kontratat ose nga ligji”*. Në analizë të kësaj dispozite ligjore në kushtet ku midis shtetasit O.M, dhe shoqërisë **UKT**, nuk rezulton e lidhur asnjë kontratë midis tyre, vlerësojmë se ankuesi nuk gëzon statusin e të qenit palë në këtë kontratë me **UKT-në**, e për pasojë nuk ka asnjë lloj detyrimi si konsumator¹ ndaj operatorit, sepse ky shërbim për furnizimin me ujë si konsumator familjar nga ana juaj është dhënë në favor të të ndjerit B.H, fakt ky që rezulton edhe nga faturat e konsumit të ujit të pijshëm, të cilat janë lëshuar në emrin e të ndjerit B.H, dhe jo të ankuesit O.M.

Duke ju kthyer rastit konkret, rezulton se i ndjeri B.H, ka lidhur kontratë furnizimi me **UKT-në**. Sipas kësaj kontrate **UKT-ja** ka marrë përsipër furnizimin me ujë për konsumatorin, ndërsa ky i fundit ka marrë përsipër pagimin e çmimit për ofrimin e shërbimit periodik.

Ky konsumator ka rezultuar debitor ndaj **UKT-së**, pasi ka detyrime të pashlyera. Në këto kushte në respektim të nenit 698 të Kodit Civil, **UKT-ja**, mund t’i kërkonte personit përmbushjen e detyrimit ose zgjidhjen e kontratës, që ka lidhur me personin, përveç shpërblimit të dëmit, veprim i cili nuk është ndërmarrë nga ana juaj.

Në këtë marrëdhënie debi-kredi ankuesi O.M, i cili nuk ka shfaqur vullnet për lidhjen e asaj kontrate nuk tërheq as të drejta dhe as detyrime. Po kështu, nuk provohet asnjë veprim juridik suksedimi i ankuesit O.M në marrëdhënien juridike që ka **UKT-ja**, me individin dhe për pasojë O.M nuk ka asnjë detyrim ndaj **UKT-së**, ndryshe nga sa **UKT-ja** relacionon në shkresën e saj.

¹ Në nenin 2.1 të kontratës tip për shërbime Ujësjellës Kanalizime e miratuar me vendim të KKRR nr.25, datë 08.07.2015, është parashikuar se: *“Konsumatorë janë të gjithë konsumatorët familjarë publike dhe privat të cilët përdorin shërbimet e ujësjellës kanalizimeve”*.

Në nenin 7, të Kontratës së Shërbimeve Ujësjiellës Kanalizime, e miratuar me vendim të Komisionit Kombëtar Rregullator të Ujit (KKRR) nr. 25, datë 08.07.2015, është parashikuar ndër të tjera se *“1. Furnizimi me ujë llogaritet në bazë të konsumit real dhe vlerësohet nëpërmjet aparateve matëse. Operatori duhet të instalojë ujëmatësin për çdo konsumator sipas legjislacionit në fuqi për metrologjinë. 2. Operatori detyrohet të furnizojë, të instalojë, të mbikëqyrë dhe të zëvendësojë ujëmatësin. 3. Operatori merr masat e nevojshme për cilësinë dhe funksionimin e ujëmatësit sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Operatori është përgjegjës për jetëgjatësinë e ujëmatësit sipas kësaj kontrate. 4. Konsumatori detyrohet për shpenzimet e furnizimit dhe të instalimit të ujëmatësit sipas faturës që jepet nga Operatori”*.

Në seksionin e dytë “Tarifat dhe pagesat”, neni 8, pika 4, është parashikuar se: *“Tarifat e shërbimeve të miratuara me vendim të Entit Rregullator të Ujit janë të detyrueshme për palët në kontratë”*.

Në nenin 9 të kësaj kontrate, pika 1, është parashikuar se: *“Fatura e konsumit të ujit të pijshëm është titull ekzekutiv. Në pikën 4 të këtij neni është parashikuar se: “ Fatura duhet të përmbajë në mënyrë të qartë të paktën elementët që vijojnë: a. Emri, mbiemri, kodi i identifikimit dhe adresa e konsumatorit”*.

Sipas nenit 10 të kontratës *“Pagesa e faturës”*, konsumatori ka patur detyrimin të paguajë faturën brenda datës 28 të muajit pasardhës tek sportelet e caktuara të operatorit, nëpërmjet llogarisë bankare, ose sipas mënyrave të tjera për të cilat kanë rënë dakord palët. Meqenëse pagesa nuk është kryer brenda 30 ditëve, pas kalimit të afatit të përcaktuar sa sipër, ju si operator keni patur të drejtën të ndërprisni furnizimin me ujë ndaj palës konsumatore të ndjerit Bardhyl Hasanbelliu, me kusht që ta njoftoni 5 ditë para, veprim i cili nuk është ndërmarrë nga ana juaj.

Gjithashtu, konstatojmë se nga ana juaj nuk janë ndjekur të plota procedurat ligjore në lidhje me vjeljen e detyrimit. Konkretisht ka rezultuar se nuk keni kryer asnjë veprim për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për faturat e konsumit të ujit të pijshëm të papaguara, të lëshuara në emër të të ndjerit B.H, detyrim ky që ju lind bazuar në parashikimet ligjore të ligjit nr. 8975, datë 21.11.2002, “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, të ndryshuar.

Në kushtet kur rezulton se i ndjeri B.H, ka ndërruar jetë, pagimi i detyrimeve të tij në përputhje me nenin 341 të Kodit Civil, i kalon trashëgimtarëve të tij të cilët duhet të

përgjigjen për detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore në përpjesëtim me pjesët e tyre takuese, gjer në vleftën e pasurisë trashëgimore që kanë marrë dhe për rrjedhojë këto detyrime nuk i takojnë ankuesit O.M.

-II-

Lidhur me qëndrimin tuaj se detyrimi rrjedh nga kontrata e lidhur me objektin i cili është furnizuar me ujë² nga shoqëria e “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a. Tiranë, në referim kjo edhe të pikës 3.2, paragrafi “1”, të Kodit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve³, në të cilin parashikohet se: *“Të gjitha objektet e lidhura me sistemin e ujësjellësit janë subjekte të pagimit të detyrimeve për ujin e pijshëm, si në rastet kur ai përdoret për konsum vetjak ashtu edhe për aktivitet prodhues”*, Institucioni i Avokatit të Popullit referuar edhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, vlerëson se ky qëndrim nuk është i drejtë me arsyetimin se kontrata e furnizimit është veprim juridik i cili lidhet midis individëve duke krijuar pasoja për ata individë dhe jo për të tretë. Koncepti i veprimit juridik e lidh ekzistencën e tij qartësisht me detyrimet që lindin prej tij për palët në kontratë, të cilët sipas rastit mund të jenë personat fizikë ose juridikë, që krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.

Në këtë kontekst eidentojmë faktin se, ky lloj shërbimi i cili është thelbësor dhe jetësor, nuk përdoret nga pasuria e paluajtshme, por nga qytetari. Në frymën e një qëndrimi të konsoliduar doktrinal dhe ligjor sqarojmë se kontrata nuk prodhon efekte për objektin, por për individin, i cili shpreh vullnetin për ta lidhur atë. Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, është një nga kushtet e nevojshme për qenien e kontratës, krahas shkakut të ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objektit që formon lëndën e kontratës si dhe formës së saj të kërkuar nga ligji⁴.

Është pikërisht shprehja e këtij vullneti nga ana e individit (palës)⁵ nëpërmjet të cilit ai realizon të drejtat dhe merr përsipër detyrime që burojnë nga kontrata. Në rastin kur nga ana e individit nuk përmbushen rregullisht detyrimet kontraktore, pala kreditore ka të drejtën që t’i kërkojë palës debitore përmbushjen e detyrimit ose zgjidhjen e kontratës. Në këtë kontekst sqarojmë se sendet mund të jenë objekt i kontratës, por asnjëherë subjekt i saj, dhe për pasojë

² Në nenin 9 të i kontratës për shërbimet e ujësjellësit parashikohet se “ *Pika e lidhjes së ujit është pika e përcaktuar nga Operatori në linjat e rrjetit shpërndarës për të realizuar lidhjen e furnizimit me ujë të konsumatorit me sistemin e furnizimit me ujë*”

³ VKM nr.1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizime sh.a “ (Kodi i Ujit).

⁴ Neni 663 i Kodit Civil

⁵ Neni 5 i kontratës për shërbimet e ujësjellësit ka parashikuar se “Palët janë operatorët dhe konsumatorët e referuar së bashku në këtë kontratë”.

në këtë frymë arsyetimi ligjor konkludojmë se nuk është objekti që ngarkohet me detyrime, por është subjekti që i merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga kontrata. Detyrimet dhe kontratat si institute juridike gjejnë rregullim ligjor në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i cili në një rubrikë të posaçme me titull “Kontratat”⁶, ka rregulluar në mënyrë të posaçme “Kontratën e Furnizimit”⁷.

Në nenin 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se: *“Kodet janë ligje që miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit”*, që do të thotë që në hierarkinë ligjore ato kanë epërsi mbi çdo ligj tjetër që miratohet me shumicë të thjeshtë, e aq më tepër ndaj akteve nënligjore të cilat dalin në bazë dhe për zbatim të ligjit.

Nisur nga fakti se furnizimi me ujë është një shërbim monopol dhe mbajtësi i monopolit UKT-ja, ka detyrimin të lidhë kontrata me të gjithë shtetasit vlerësojmë se, nuk ka asnjë pengesë ligjore që UKT-ja, të lidhë kontratën e furnizimit me z. O.M. Për më tepër, UKT-ja, e cila ka edhe monopolin si subjekt dominues në treg nuk mund ta përdorë pozitën e tij për të dëmtuar interesat e shtetasve që kanë pozitë inferiore. Në kushtet kur në një kontratë njëra nga palët ka pozicion më të fortë dhe pala tjetër pozicion inferior, ligji priret të favorizojë palën e cila është inferiore në një kontratë.

Sa më sipër, pretendimi i UKT-së që e lidh detyrimin kontraktor me objektin nuk qëndron dhe as është i rregullt. Çdo veprim i kryer nga UKT-ja, për të kërkuar këtë interpretim, edhe nëse do të kishte parashikim të qartë në kontratë, do të ishte abuziv dhe i paligjshëm. Vlerësojmë se UKT-ja, duhet të gjejë instrumentet e duhur ligjor për të vjelë detyrimin e prapambetur nga debitori në përputhje me legjislacionin ligjor në fuqi.

Më tej duke u fokusuar në njohjen dhe aplikimin e standardeve ndërkombëtare, theksojmë faktin se Rezoluta 64/292 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, njeh të drejtën për ujë të pijshëm dhe kanalizime të sigurta dhe të pastërta, si një ‘e drejtë e njeriut’ që është thelbësore për gëzimin e plotë të të gjitha të drejtave. Shqipëria është një nga vendet që ka nënshkruar Deklaratën e Mijëvjeçarit duke u angazhuar në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit deri në vitin 2015 dhe në shtatëmbëdhjetë Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ), të cilat kanë si afat vitin 2030. Në këtë axhendë të re të zhvillimit, *uji dhe kanalizimet konsiderohen të kenë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa ato kanë lidhje me disa probleme kryesore globale dhe kanë ndikim në*

⁶ Neni 659, e vijues të Kodit Civil

⁷ Neni 772, e vijues të Kodit Civil

të gjitha aktivitetet njerëzore. Në përputhje edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të proklamuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në kuadër të Axhendës 2030, deri në vitin 2030, nga ana e autoriteteve shtetërore duhet të arrihet një qasje universale dhe e barabartë në ujë të pijshëm të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë⁸.

-III-

Një tjetër problematikë e evidentuar gjatë trajtimit të këtij rasti është se, pavarësisht faktit se titullari i kontratës nr.018389-1, i ndjeri B.H ka ndërruar jetë në vitin 2003, faturat e ujit të pijshëm kanë vijuar ende të lëshohen në emër të tij, edhe për shumë vite pas.

Në kushtet kur Ujësjellës-Kanalizime Tiranë, sh.a, kryen edhe shërbimin e agentit tatimor për vjeljen taksave dhe të tarifave familjare të qytetarëve në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, rezulton se në faturat e lëshuara nga UKT-ja në emër të të ndjerit janë të përfshira veç tarifës së ujit të pijshëm edhe pagesa e taksave dhe tarifave vendore siç është taksa për pronën, e infrastrukturës arsimore, si dhe tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave.

Meqenëse informacioni që përmban listën e saktë të qytetarëve që mbartin detyrime për pagimin e taksave dhe tarifave të cituara sa sipër, si dhe informacioni lidhur me vlerën e përlllogaritjes së këtij detyrimi bëhet nga Bashkia Tiranë dhe më tej i dërgohet Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a, për ta rregjistruar në të dhënat bazë të klientit (qytetarit) konkludojmë se, në rastin konkret ka patur mungesë të bashkërendimit të punës midis jush dhe Bashkisë Tiranë në kuadër të përditësimit të informacionit lidhur me listën e plotë dhe të saktë të qytetarëve, bazuar kjo edhe në të dhënat e marra nga Zyrat e Gjendjes Civile. Në këtë kontekst vlerësojmë se do të ishte efikase ngritja e një sistemi të përbashkët informatik midis Bashkisë Tiranë dhe Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a, në ushtrim të veprimtarisë së tij si agent tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave familjare nga qytetarët, me qëllim përditësimin në kohë reale të informacionit lidhur me listën e plotë dhe të saktë të qytetarëve (konsumatorëve), të cilët mbartin detyrime për pagimin e taksave dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Tiranë.

Në vijim të analizës sonë, në kuadër të bashkëpunimit gjatë procesit të zhvillimit të hetimit administrativ, eidentojmë edhe një herë faktin se gjatë komunikimit institucional me UKT-në, ka rezultuar se edhe pse janë kthyer përgjigje në aspektin formal lidhur me kërkesat për shpjegime apo informacion të dërguara nga Avokati i Popullit, në vlerësimin tonë ato nuk

⁸ OZHQ 6.1

mund të konsiderohen të tilla në aspektin substancial, pasi nuk i keni kthyer përgjigje në mënyrë të përsëritur, çështjeve të specifikuar për informacion nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të cilat kanë rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

Duke e konsideruar refuzues qëndrimin e mbajtur prej UKT-së, në më shumë se në një rast, çmohet se ky qëndrim ka cënuar një ndër parimet më të rëndësishme parimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike.

Parimi i bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike, është sanksionuar si në parimet e Kodit të Procedurës Administrative, ashtu edhe në ligjin nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore". Neni 3 i këtij ligji parashikon se: *"Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve të pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin"*.

Në këtë kontekst, sqarojmë se bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Mungesa e informacionit dhe e dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme, apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti i së drejtës dhe administrata shtetërore, ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

Në këtë këndvështrim, duam t'ju kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Evropian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit: *“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”*.

Sa sipër, bazuar në neni 63, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe nenin 21, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se : *“ Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit kryen këto veprime ..., b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, c) Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*;

REKOMANDOJMË

- Marrjen e masave për përfundimin e procedurës administrative bazuar në kërkesën e shtetasit O.M, për pajisjen me kontratë furnizimi me ujë.
- Marrjen e masave lidhur me nxjerjen e përgjegjësive dhe evidentimin e personave që kanë çuar në cenimin e së drejtës së ankuesit, duke mos vijuar me procedurën e lidhjes së kontratës së furnizimit me ujë me shtetasin O.M.
- Marrjen e masave nga “Ujësjiellës-Kanalizime” Tiranë, sh.a, (si kreditor), për ndjekjen e procedurave përkatëse ligjore për vjeljen e detyrimeve të prapambetura, nga debitori (trashëgimtarët e tij), referuar **kontratës të Shërbimeve Ujësjiellës Kanalizime nr. 018389-1**, që këto palë kanë patur të lidhur midis tyre.
- Marrjen e masave administrative dhe ligjore për mospërsëritjen e situatave të tilla në raste analoge në të ardhmen, pra të mosveprimit të institucionit tuaj, duke mos respektuar procedurat ligjore dhe të drejtat e shtetasve.
- Marrjen e masave për ngritjen e një sistemi të përbashkët informatik midis Bashkisë Tiranë dhe Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a (si agjent tatimor), me qëllim përditësimin e informacionit lidhur me listën e plotë dhe të saktë të qytetarëve që mbartin detyrime për pagesën e taksave dhe tarifave vendore konkretisht taksës mbi ndërtesën, taksës së përkohshme për infrastrukturën

arsimore, si dhe tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave, brenda juridiksionit të Bashkisë Tiranë.

- Marrjen e masave përkatëse për të adresuar mungesën e komunikimit korrekt me institucionin e Avokatit të Popullit sa i përket kërkesave për informacion, në lidhje me të cilat përgjigjet kanë rezultuar me përmbajtje të paplota në disa aspekte, me qëllim që kjo situatë të mos përsëritet në të ardhmen.
- Adresimin e problematikës pranë Entit Rregullator të Ujit, me qëllim marrjen e masave për rregullimin e situatës në të ardhmen, në kuadër të unifikimit të qëndrimit ligjor se nuk është objekti⁹ i lidhur me sistemin e ujësjellësit që ngarkohet me detyrime, por është subjekti (konsumatori), i cili merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga kontrata e ujit.

Në zbatim të nenit 22, të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, “ Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi, lutemi të na vini në dijeni mbi qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi si dhe masat e marra për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

KOMISIONERE

ERINDA MELI

d.v

⁹ Në referim kjo edhe të pikës 3.2, paragrafi “1”, të Kodit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, në të cilin parashikohet se: “Të gjitha objektet e lidhura me sistemin e ujësjellësit janë subjekte të pagimit të detyrimeve për ujin e pijshëm, si në rastet kur ai përdoret për konsum vetjak ashtu edhe për aktivitet prodhues” organizative që kjo shkelje të mos përsëritet në të ardhmen.